



E enjte , 8 janar 2008

## NJOFTIM PËR MEDIA

### Shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike për vitin 2009

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), e informon opinionin e gjer publik, se në fund të dhjetorit 2008 ka pranuar aplikacionet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A.) dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A.) për të hyrat e lejuara, përkatësisht tarifat për energji elektrike për vitin 2009.

Shqyrtimit i aplikacioneve të KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A. për tarifat me pakicë për konsumatorët shtëpiakë dhe ata komerciale do të jetë një proces transparent, dhe i bashkërenditur me palët e interesuara.

Gjatë këtij procesi ZRRE-ja do të analizojë në detaje aplikacionet e pranuar dhe do të bëjë verifikimin e të dhënave teknike dhe financiare të prezantuara, ku përfshihen edhe shpenzimet operative dhe kapitale të ndërmarrjeve energjetike, duke marrë parasysh edhe përbalueshmërinë e konsumatorëve për të paguar shpenzimet e energjisë elektrike.

Pas shqyrtimeve dhe analizave ZRRE-ja do të dalë me një propozim konsultativ mbi të ardhurat e lejuara për ndërmarrjet energjetike, përkatësisht tarifat për vitin 2009. Ky propozim do të bëhet publik dhe do të vendoset edhe në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së. Lidhur me këtë palët e interesuara mund të japin komentet e tyre, të cilat do të mirren në konsiderim gjatë përpilimit të propozimit përfundimtar të të ardhurave të lejuara përkatësisht tarifave të ndërmarrjeve energjetike.

Ky proces do të zhvillohet sipas një orari tashmë të publikuar dhe do të zgjasë deri në muajin mars, kur pritet që të ardhurat e lejuara përkatësisht tarifat e energjisë elektrike të aprovohen nga Bordi i ZRRE-së të cilat pritet të zbatohen duke filluar nga 1 prilli 2009.